



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.473/23
Datë: 07.07.2023

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, UA-MPMS, Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe UA-MASHT, Nr.01/2022 për Ndryshim dhe Plotësim të UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe UA-MASHT, Nr.05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënësit për vitin shkollor 2023/24

SHFMU "Bajram Curri" në Istog

1. Një edukatore për parafillor në paralelen e ndarë në Cerrcë vendi i lirë i punës.
2. Një mësimdhënëse/e për Gjuhë Gjermane, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë - starton me punë nga data 05.11.2023.
3. Një mësimdhënëse/e për Gjuhë shqipe, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë - starton me punë nga data 01.10.2023
4. Një mësimdhënëse/e për Edukatë Muzikore, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë .
5. Një mësimdhënëse/e për mësim klasor (1-5), zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësjja nga pushimi i lehonisë.
6. Një mësimdhënëse/e për Histori zëvendësim derisa mësimdhënësi të kthehet nga pushimi mjekësorë.

SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë

1. Një mësimdhënëse/e për mësim klasor (1-5), vendi i lirë i punës nga 01.09.2023 paralelja e ndarë Prigodë.
2. Një mësimdhënëse/e për mësim klasor (1-5), vendi i lirë i punës nga 17.10.2023 paralelja e ndarë Prigodë.
3. Një mësimdhënëse/e për Gjuhë Gjermane, normë jo e plotë në dy shkolla, "Hysni Zajmi" Vrellë dhe "Zymer Zeka" në Kaliqan.

SHFMU "Martin Camaj" në Gurrakoc

1. Një mësimdhënëse/e për Gjuhë Gjermane, me plotësim norme në SHFMU "Bajram Curri" në Istog.
2. Një mësimdhënëse/e për Fizikë vendi i lirë i punës.

SHFMU "Trepça" në Banjë

1. Një mësimdhënës/e për Kimi (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë në Banjë dhe Dobrushë.
2. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze për nxënësit e komunitetit Boshnjak.
3. Një mësimdhënës/e për Gjeografi për nxënësit e komunitetit Boshnjak.

SHFMU "Ismail Qemali" në Staradran.

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane me plotësim norme në SHFMU "Avni Rrustemi" Zallq dhe SHFMU "Fan.S.Noli" Lukac i Begut norme jo e plotë.
2. Një mësimdhënës/e për Matematikë me plotësim norme në SHFMU, "Ndre Mjeda" Rakosh vendi i lirë.
3. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe norme jo e plotë vendi i lirë.
4. Një mësimdhënës/e për mësim klasor (1-5), vendi i lirë i punës nga 01.09.2023 paralelja e ndarë Trubohofc.

SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, normë jo e plotë në tri shkolla "Ndre Mjeda" Rakosh, "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" në Uçë dhe "Mehmet Akif" në Shushicë
2. Një mësimdhënës/e për Fizikë norme jo e plotë.
3. Një mësimdhënës/e për Kimi në katër shkolla SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh, SHFMU "Mehmet Akif" Shushicë, SHFMU "Avni Rrustemi" Zallq dhe SHFMU "Ismail Qemali" në Saradran.
4. Një mësimdhënës/e për TIK 6+4 orë mësim zgjedhorë në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog.

SHFMU "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" në Uçë

1. Një mësimdhënës/e për mësim klasor (1-5) zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësja nga pushimi i lehonisë.
2. Një mësimdhënës/e për Fizikë norme jo e plotë
3. Një mësimdhënës/e për Gjeografi në tri shkolla SHFMU "Martin Camaj" në Gurrakoc dhe SHFMU "Avni Rrustemi" në Zallq norme e plotë vendi i lirë i punës nga data 30.10.2023

SHFMU "Avni Rrustemi" në Zallq

1. Një mësimdhënës/e për Fizikë me plotësim norme në SHFMU "Fan.S.Noli" Llukac i Begut, norme jo e plotë.

SHFMU "Fan.S.Noli" në Llukac i Begut

1. Një mësimdhënës/e për Biologji (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë në Dobrushë dhe SHFMU "Trepça" Banjë.
2. Një mësimdhënës/e për TIK (në gjuhën boshnjake), normë jo të plotë në Dobrushë dhe SHFMU "Trepça" Banjë.
3. Një mësimdhënës/e për Histori (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë në Dobrushë dhe SHFMU "Trepça" Banjë.

SHFMU "Mehmet Akif" në Shushicë

1. Një mësimdhënës/e për Matematikë zëvendësim deri në përfundim të mandatit të drejtorit të SHFMU-së "Mehmet Akifi" Shushicë (pozitë me afat të caktuar) normë jo e plotë.
2. Një mësimdhënës/e për mësim klasor (1-5), zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësja nga pushimi i lehonisë.

SHFMU "Zymer Zeka" në Kaliqan

1. Mësimdhënës/e për gjuhë angleze- zëvendësim deri në përfundim të mandatit të drejtorit të SHFMU-së "Zymer Zeka" Kaliqan (pozitë me afat të caktuar) normë jo e plotë, me mundësi të vazhdimit të kontratës pas pensionimit të drejtorit.

Gjimnazi "Haxhi Zeka" në Istog

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, me plotësim norme në IAAP "Mithat Frasheri" në Gurrakoc.
2. Një mësimdhënës/e për matematik-mësim zgjedhorë norme jo e plotë

IAAP "Mit'hat Frashëri" në Gurrakoc

1. Një mësimdhënës/e për TIK, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë në dy shkolla
2. Një mësimdhënës/e për Gjuhë shqipe, vend i lirë nga data 05.09.2023
3. Një mësimdhënës/e për Gjuhë shqipe, vend i lirë nga data 15.11.2023

IP "Gëzimi Ynë" Istog

1. Një motër edukatore për grup moshat 0-3 zëvendësim deri sa të kthehet edukatorja nga pushimi pa pagesë.
- Gjithashtu, Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, duke u bazuar në rekomandimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit shpallë edhe 10 pozita pune për Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Kandidatëve për këto pozita, sipas nenit 8 pika 6 e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, u kërkohet kualifikimi si me poshtë:
 - Nivelit i 5-të (post sekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes.
- Kopja e diplomës ose certifikata në vend të diplomës jo me e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, MASHTI, Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 07.08.2023 deri më datë 21.08.2023.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhes dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili dorëzohet pas afatit nuk do të shqyrtohet. Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret, bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi, kurse intervistës do t'i nënshtrohen vetëm kandidatët – kandidatet, të cilët- të cilat arrijnë të kenë me shumë se 50 për qind të kalueshmërisë së testit me shkrim.



Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Naim Behlulaj